



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TË RRETHIT GJYQËSOR
FIER

Nr.71023-02145-62-2018(1517) i Regj.Them.
Dt.13.07.2018 e Regjistrimit

Nr.62-2018-4347(1484) i Vendimit
Dt.13.09.2018 e Vendimit

VENDIM
“Në emër të Republikës”

Gjykata e Shkallës së Parë e Rrethit Gjyqësor Fier, e përbërë prej trupit gjykues:

Gjyqtar – Piro SOTA

Asistuar prej sekretares gjyqësore *Florida Agalliu*, në Fier, në dt.13.09.2018 përfundoi shqyrtimin në seancë gjyqësore publike të çështjes penale me palë:

KËRKUES Ermal Hoxha, atësia Ilir , amësia Teuta, me dt.lindje 08.06.1975, lindur dhe banues në Tiranë,Unaza e Re, rruga Foto Xhavella, i martuar me dy fëmij, me arsim të lartë, i dënuar pranë IEVP Fier, i përfaqësuar nga av. Ermir Beta.

PERSONA TË INTERESUAR :

1-Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier e përfaqësuar nga prokurori *Asllan Barjamaj*.

2- Instituti i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Fier. i përfaqësuar nga *Ana Bako, Juliana Nebiaj, dhe Sidorela Vogli*.

OBJEKTI Lirim me kusht.

BAZA LIGJORE: Nenet ; 64 i K.Penal. 477 i K.Pr.Penale dhe 31/6 i ligjit “ *Për ekzekutimin e vendimeve penale*”.

Gjykata pasi shqyrtoi aktet në munges të kërkuesit dëgjoi palët e pranishme që në diskutimin përfundimtar kërkuan:

MBROJTËSI Ermir Beta: Pranimin e kërkesës.

PËRFAQSUESJA Sidorela Vogli:Pranimin e kërkesës.

PROKURORI Asllan Barjamaj: Mospranimin e kërkesës.

Gjykata pasi vlerësoi në tërësi provat;

V Ë R E N

Kërkuesi Ermal Hoxha, ka paraqitur kërkesën në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, për lirim me kusht, konformë nenit 64 të K.Penal dhe 477 të K.Pr.Penale.

Kjo gjykatë çmon të evidentojë së pari se është kompetente nga pikpamja lëndore e territoriale për shqyrtimin e kësaj kerkese.

Në nenin 477 të K.Pr.P parashikohet se:

“Gjykata e vendit të ekzekutimit vendos për lirimin me kusht dhe revokimin e vendimit të lirimit me kusht, sipas kritereve të parashikuar në Kodin Penal.”

Në nenin 31/6 të ligjit “ Për ekzekutimin e vendimeve penale ” parashikohet se:

“I dënuari me burgim, në përputhje me nenin 64 të K.Penal, ka të drejtë të paraqes kërkesë për lirim me kusht në gjykatën e vendit të ekzekutimit të dënimit.”

Përsa i përket përcaktimit të kompetencës funksionale, në bazë të gërmës “dh” të pikës “2” të nenit 13 të K.Pr.P.do të jetë trupi gjykues monokratik ai që shqyrton këto çështje.

Lidhur me shqyrtimin në themel të kërkesës, nga provat e administruara gjatë këtij gjykimi ka rezultuar se:

Me vendimin nr.69 dt.11.07.2017 të Gjykatës së Krimeve të Rënda Tiranë, lënë r.e fuqi me vendimin nr.93. dt.15.11.2017 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, kërkuesi Ermal Hoxha është deklaruar fajtor, dhe dënuar me 6 vjet e 8 muaj burgim për veprat penale të parashikuara nga nenet 283/1, 284-c-1, 334-1 dhe 33-a-2 të K.Penal si dhe 406-1 i K.Pr.P. Llogaritja e vuajtjes së dënimit ka filluar nga dita e arrestimit dt.15.01.2015 dhe vuajtja e dënimit për të dënuarin Ermal Hoxha është urdhëruar të bëhet në një burg të sigurisë së zakonshme.

Pasi vendimi ka marrë formë të prerë, prokurori ekzekutimeve të vendimeve penale ka nxjerrë urdhërin e ekzekutimit të dt.06.12.2017.

Aktualishtë I dënuari Ermal Hoxha vuan pjesën e mbetur të dënimit në I.E.V.P Fier.

Nga dinamika e vuajtjes së dënimit me nr.4610 dt.20.07.2018, për të dënuarin Ermal Hoxha rezulton, se i dënuar deri në këtë datë nga dënimi i dhënë ka vuajtur fizikisht 3 vjet e 6 muaj e 5 ditë burgim. Me kohën e paraburgimit ka fituar 1 vit e 5 muaj burgim. Me aktivizim pune i janë ulur 1 muaj e 2 dite burgim. Nga dënimi i dhënë ka kryer gjithsej 5 vite e 7 ditë burgim.

Në ditën e marrjes së këtij vendimi të dënuarit Ermal Hoxha i mbeten për të vuajtur edhe 1 vit 6 muaj e burgim.

Në zbatim të detyrimeve të parashikuara neneve; 59 të ligjit “ *Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve* ” dhe 113 të V.K.M nr.437 dt.20.05.2015 “ *Për Miratimin e Rregullores së Përgjithëshme të Burgjeve* ”, Komisioni i vlerësimit të sjelljes së të burgosurve pranë I.E.V.P. Fier me aktin “**Vlerësim sjellje për në gjykatë**” nr.3272 prot. dt.20.07.2018 ka tërhequr konkluzionin se i dënuari Ermal Hoxha ka shfaqur sjellje korrekte duke respektuar rreguloren e institucionit e se ai i plotëson kriteret ligjore për të përfituar lirim me kusht.

Me urdhërat nr.161/4 dt.28.03.2018, nr.358/4 dt.04.07.2018, për shkak të sjelljes së mirë, i dënuari Ermal Hoxha ka përfitur dy herë leje shpërblyese.

Në zbatim të nenit 31 të V.K.M. nr.302 dt.25.03.2009 “Për miratimin e rregullores “*Për organizimin e funksionimin e shërbimit të provës dhe për përcaktimin e standarteve e të procedurave, për mbikqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative*”, **Zyra Vendore e Shërbimit të Provës Fier me aktin “ Raport i vlerësimit për të dënuarin ”** të dërguar me shkresën përcjellse nr.524/1 prot. dt.11.09.2018 ka aritur në konkluzionin se riintegrimi i të dënuarit Ermal Hoxha në shoqëri, është i mundshëm për arsyet e mëposhtme:

- a) Gjatë intervistave me punonjësin e Shërbimit të Provës shprehet i penduar për veprën e konsumuar. Ai është ndërgjegjësuar për veprën dhe dënon veprimin e tij çka tregon se ky i dënuar është rehabilituar dhe është i gatshëm për t'u riintegruar në shoqëri.
- b) Nga vërtetimi i gjëndjes gjyqësore figuron se I dënuari Ermal Hoxha nuk ka qënë më parë i dënuar.
- c) I dënuari ka paraqitur edhe nje vërtetim pune nga pundhënësi ku vërteton se do të filloj punë në rast të liritimit të tij, gjë e cila ndihmon në rehabilitimin e shpejt të të dënuarit në shoqëri.

- d) I dënuari nuk rezulton të ketë probleme me përdorimin e alkolit apo të lëndëve narkotike, faktor i cili ndikon në procesin e riintegrit të të dënuarit në shoqëri dhe shërben si një faktor parandalues në kryerjen e sjelljeve devijante në shoqëri
- e) I dënuari do të kujdeset për veten dhe familjen e tij.
- f) Lidhur me konsultimin e dokumentave dhe materialeve të dosjes së të dënuarit si dhe nga intervista me të, rezulton se i dënuari ka mbështetjen e plotë të familjes dhe të shoqërisë, fakt i cili ndikon pozitivisht tek riintegrimi i të dënuarit.

Nga vertetimi i gjëndjes gjyqësore nr.1 prot, dt.05.07.2018 rezulton se kërkuesi nuk ka dënim tjetër përveç dënimit të mësipërm.

Nga akti “Kontratë Punësimi” e dt.12.08.2018 rezulton se i dënuari Ermal Hoxha do të punësohet me detyrën e ekonomistit pranë shoqërisë Hera Company Sh.P.K, pas periudhës së Shërbimit të Provës në rastë se lirohet nga burgimi.

Kundrejt gjëndjes së faktit sa më sipër mbrojtësi i kërkuesit dhe përfaqësuesja e IEVP-ës u shprehën për pranimin e kërkjesës, ndërsa prokurori u shpreh për rrëzimin e kërkjesës me pretendimet se:

1- Vertetohet se i dënuari është denuar për vepra penale që kryhen vetëm në kuadër të një organizate kriminale dhe grupet e strukturuar dhe nuk është veprimtari kriminale e lindur aty për aty dhe që parashikojnë marzhe denimi dhe kërkojnë kohë dhe një angazhim maksimal të organeve ligjzbatuese si forma e sofistikuar e krimit në Republikën e Shqipërisë. Nuk ka asnjë provë ose të dhënë që i dënuari paraqet arsye të vecante që mundet të ligjerojë lirimin e tij para kohe dhe venien e tij në provë pasi këto veprimtari kriminale me sofistikimin e mënyrës sesi kryhen nuk japin asnjehere garanci se personat e përfshirë në këto lloj krimesh dhe bashkëpunime të tilla rehabilitohen dhe është e mundur parandalimi tyre me masa alternative dhe jo ndeshkuese. Përkundrazi praktika ka treguar se personat e denuar për këto vepra penale jo vetëm që nuk rehabilitohen por përfshihen në krime me të rënda pas vuajtjes së dënimit kur është bërë e mundur dënimit tyre.

2- I dënuari nuk paraqiti në gjykim asnjë deklaratë ku të tregojë pendim për veprimet e kryera dhe kërkojë falje, nuk ka bashkëpunuar në asnjë moment me organet e drejtësisë dhe as kryer ndonjë veprime tjetër që mundet të krijojnë bindjen se me punën dhe dhe qëndrimin e tij është arritur rehabilitimi i tij dhe për pasojë nuk provohet as ky kusht ose kriter i vendosur nga neni 64 K.Penal.

3- Një fakt tjetër që nuk të krijojnë bindjen se i dënuari me punën dhe masën e dënimit

që ka vuajtur është arritur qëllimit për rehabilitim është se rezulton se i denuari është arrestuar në datë 16.01.2015 dhe aktualisht ka qëndruar në izolim prej 3 vjet e 8 muaj. pikërisht kjo masë e vuajtur në izolim për veprat penale për të cilat ai është denuar nuk tregon një kohë të madhe dënimi dhe që mundet të bëjë të reflektoj atë por thjesht është një kohë me e shkurter e mundur e dënimit që i dënuari e ka marrë parasysh si kosto kur është përfshirë në organizate kriminale dhe nuk ka se si kjo masë të krijojë bindjen se është arritur rehabilitimi i tij.

Gjykata i gjën ta pabazuara kundërshtimet e prokurorit pasi:

Së pari: Vepra penale për të cilën është dënuar kërkuesi ka të bëjë me gjykimin në themel çështjes për të cilën ai ka marrë dënimin përkatës. Nëse vepra penale për të cilën është dënuar kërkuesi nuk do të jepte garanci se autorët e saj mund të rehabilitoheshin, ligjvënësi do ti kishte parashikuar ato në kushtet penguese të paragrafit 3 të nenit 64 të K.Penal.

Së dyti: Përsa i përket qëndrimit të të dënuarit për veprën penale që ka kryer, ligjvënësi nuk ka parashikuar në nenit 64 të K.Penal paraqitjen e ndonjë deklaratë apo dokumenti të veçantë nga i dënuari para trupit gjykues, po ka ngarkuar komisionin përkatës pranë IEVP-ës dhe Zyren Vendore të Shërbimit të Provës të cilat në aktet që përpilojnë lidhur me të dënuarin evidentojnë në to edhe qëndrimin që ai mban ndaj faktit kriminal që ka kryer. Si Zyra Vendore e Shërbimit të Provës ashtu edhe Komisioni i Vlerësimit të Sjelljes së të Burgosurve pranë I.E.V.P. Fier me aktet e tyre depozituar pranë kësaj gjykate, kanë tërhequr konkluzione pozitive edhe në drejtim të qëndrimit pendues të të dënuarit për veprën e kryer, të cilat gjykata i vlerëson plotësisht të bazuara.

Së treti: Në paragrafin e parë të nenit 64 të K.Penal ligjvënësi nuk kërkon që i dënuari të ketë vuajtur një *“kohë të madhe dënimi”*, por e ka lidhur atë me një periudhë të caktuar kohë në raport me sanksionet që parashikojnë veprat penale për të cilat ai është dënuar.

Në vlerësimin në tërësi të provave të marra në shqyrtim gjatë këtij gjykimi, gjykata arrin në përfundimin se në kërkesën e kërkuesit Ermal Hoxha, konkurojnë rrethanat e evidentuara në **nenin 64 të K.Penal** në të cilin parashikohet se:

“I dënuari me burgim mund të lirohet me kusht, nga vuajtja e dënimit vetëm për arsye të veçanta, nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij, si dhe të ketë vuajtur:

-jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi nga pesë gjer në njëzet e pesë vjet burgim.

Në rastin konkret kërkuesi ka vuajtur më shumë se tre të katërtat e dënimit të dhënë dhe me punën dhe sjelljen e tij gjatë periudhës së burgimit ka treguar se i ka arritur qëllimit të edukimit të tij.

Nga aktet “Vlerësim sjellje për periudhën 6 mujore” nr.251 prot. dt.07.02.2017, “Vlerësim sjellje për në gjykatë” nr.871 prot. dt.24.04.2018, dhe nr.3272 prot. dt.20.07.2018 rezulton se i dënuari Ermal Hoxha është përfshirë në veprimtari punësimi në institucion.

Si arsye të veçantë në kuptim të nenit 64 të K.Penal, gjykata përveç sa më sipër me r parasysh edhe gjëndjen familjare të kërkuesit ku nga martesja e parë ka një fëmijë të mitur, Rei Hoxha të dt.lindjes 16.10.2000. ndërsa nga martesja e dytë ka një fëmijë tjetër të mitur, Hera Hoxha e dt.lindjes 23.10.2013.

Por përsa i përket arsyeve veçanta të parashikuar në nenin 64 të K.Penal gjykata ka parasysh edhe **Vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë nr.2 dt.25.05.2015** në të cilin është tërhequr konkluzioni se:

“ Ligjvënësi duke përdorur shprehjen “arsye të veçanta” ka bërë një vlerësim të përgjithshëm. pa i nominuar ato e duke e lënë në vlerësim të gjykatës sipas rrethanave konkrete që i paraqiten. Megjithatë, këto “arsye të veçanta” nuk janë të pavarura dhe duhet të jenë të lidhura ngushtë me qëllimin e institutit të lirim para kohe me kusht i cili ka të bëjë me riedukimin dhe riintegrimin në shoqëri të të dënuarit. Arsyet e veçanta nuk janë gjë tjetër veçse rrethana konkrete, të cilat provojnë se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi për edukimin dhe i dënuari është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri. Ky interpretim i paragrafit të parë të nenit 64 të Kodit Penal të çon në konkluzionin logjik se kemi të bëjmë me një kusht të vetëm dhe “arsyet e veçanta” nuk janë gjë tjetër veçse fakte të cilat provojnë se me pjesën e dënimit të vuajtur është arritur qëllimi i dënimit penal në rastin konkret për edukimin e të dënuarit dhe ai është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri.”

Përsa i përket kohës së provës gjatë së cilës kërkuesi duhet të mbajë kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës, gjykata ka parasysh po vendimin e mësipërm unifikues të Gjykatës së Lartë në të cilin është tërhequr konkluzioni se:

“Në rastin kur gjykata pranon kërkesën e të dënuarit për lirim para kohe me kusht, në mbështetje të nenit 64 të Kodit Penal dhe të ligjit nr.8331, datë 21.04.1998 “Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale” ajo cakton një periudhë kohe ku i dënuari detyrohet të mbajë kontakte me shërbimin e provës si dhe vendos, sipas rastit, një ose më shumë detyrime në bazë të nenit 60 të Kodit Penal.

Në mungesë të një rregullimi të saktë ligjor, koha e provës do të jetë e barabartë me kohën e mbetur të masës së dënimit me burgim për të dënuarin që lirohet me kusht.”

Në rrethanat e mësipërme Gjykata arrin në përfundimin se kërkesa e kërkuesit është plotësisht e bazuar në prova dhe në ligj dhe si e tillë ajo duhet të pranohet duke u urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të pjesës së mbetur të dënimit prej 1 vit 6 muaj burgim, me kusht që gjatë një afati prove të barabartë me pjesën e mbetur të dënimit, i dënuari Ermal Hoxha të mbajë kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës dhe të mos kryej asnjë vepër tjetër penale.

Në zbatim të pikës 5 të nenit 64 të K.Penal, gjykata çmon që të jap ndaj kërkuesit detyrimin e parashikuar në pikën 9 të nenit 60 të K.Penal. ku gjatë kohës së provës kërkuesi të mos shoqërohet me persona të dënuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata duke parë edhe nenet; 379-382. të 470, 471/1 e 477 i K.Pr.Penale, 60/9, 64 të K.Penal si dhe Vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë nr.2 dt.25.05.2015.

V E N D O S I

1-Pranimin e kërkesës së kërkuesit Ermal Hoxha.

2-Pezullimin e ekzekutimit të pjesës së mbetur të dënimit të të dënuarit Ermal Hoxha prej 1 vit 6 muaj burgim, me kusht që gjatë një afati prove të barabartë me pjesën e mbetur të dënimit, i dënuari Ermal Hoxha të mbajë kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës dhe të mos kryej asnjë vepër tjetër penale.

3-Detyrimin e kërkuesit Ermal Hoxha që në zbatim të pikës 9 të nenit 60 të K.Penal, gjatë kohës së provës të mos shoqërohet me persona të dënuar.

4-Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të dënuarit Ermal Hoxha nga IEVP Fier.

5-Shpenzimet proceduriale në shumën 840 lekë i ngarkohen kërkuesit Ermal Hoxha.

6-Kundër këtij vendimi lejohet apel në Gjykatën e Apelit Vlorë brenda 15 ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes.

7- Për kërkuesin Ermal Hoxha në mungesë afati i ankimit fillon nga e nesërmja e marrjes dijeni për vendimin

U shpall në Fier me dt.13.09.2018

**Sekretare
Florida Agalliu**



**Gjyqtar
Piro Sota**



